



Pranuar / Dorezuar Primijsen / Prodato Received / Delivered	22 - 08	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIPSHUR	4870/2022		115	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.129/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.br.1071/2020 të datës 20.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.129/2020 të datës 21.04.2020 të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson me dhe me adresë rruga B, c15/10, Nr.2 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 124/2020 të datës 30.03.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.08.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.129/2020 të datës 21.04.2020 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i emëruar sipas Vendimit me Nr. Ref:140/14 të datës 04.03.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme si anëtar i shërbimit të jashtëm në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Bullgarisë, ndërsa me Vendimin me Nr. 049/2015 të datës 30.12.2015 duke ju ngritur grada në Këshilltar është transferuar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Hagë/Holandë, mirëpo sipas Vendimit me Nr. 220/2017 të datës 18.12.2017 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrit të Punëve

të Jashtme është transferuar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari. Tutje sipas Vendimit të datës 15.07.2018 të Zëvendëskryeministrit të parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme ankuesit i vazhdohet mandati i shërbimit në mision diplomatik në Sofje/Bullgari deri më datë 30.03.2022.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 30.03.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 124/2020 përmes të cilit ankuesit i përfundon mandati më datë 30.06.2020 me arsyetimin që nuk i është nënshtruar procedurave të pranimit në shërbimin e jashtëm sipas Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe as procedurave dhe rregullave të përcaktuar të pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 124/2020 të datës 30.03.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 21.04.2020 përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 765/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Ndërsa me datë 28.04.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Vendimit me numër Reference 37/2020 të datës 14.05.2020 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.05.2020 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 21.05.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi më datë 02.06.2020 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.07.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1071/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 02.06.2020 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 21.04.2020.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr.Prot:765/2020 e datës 21.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.04.2020; Vendimin me Nr. 124/2020 i datës 30.03.2020; Vendimin me Nr. Ref:140/14 i datës 04.03.2014; Vendimin me Nr. 049/2015 i datës 30.12.2015; Vendimin me Nr. 220/2017 i datës 18.12.2017; Ftesë për pjesëmarrje në testim nga Zyra e Personelit MPJ për ankuesin; Ftesë për gjuhën gjermane; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.05.2020; Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2020; Vendimin me numër Reference: 37/2020 i datës 14.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin e datës 18.07.2018; Vendimin me Nr. 032/2016 i datës 29.01.2016; Kërkesën për punësim të ankuesit për Anëtar të Personelit Diplomatik; Dëshminë e dokumenteve të dorëzuara e datës 10.08.2011; Certifikatën Shëndetësore e datës 28.07.2011 e ankuesit; Faturë me Nr. 003577; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë PN.nr.11186/11 e datës 29.07.2021; Certifikatën me Nr. 05-711/1-51 e datës 01.08.2011 e lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës; Njoftim për dorëheqje e datës 10.03.2014; Diplomë; Diplomën me Nr. 003092; Diplomë me Nr. 453161; CV-në e ankuesit; Njoftimin e datës 02.06.2020 për ankuesin dhe Aktgjykimin A.br.1071/2020 të datës 20.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e palejuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 30.03.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 124/2020 përmes të cilit ankuesit i përfundon mandati më datë 30.06.2020 me arsyetimin që nuk i është nënshtruar procedurave të pranimit në shërbimin e jashtëm sipas Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe as procedurave dhe rregullave të përcaktuar të pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrëndojë ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në kohën e nxjerrjes së aktit administrative respektivisht Vendimit me Nr. 124/2020 të datës 30.03.2020, ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *"1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat*

*për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”, rrjedhimisht ankuesi kundër këtij akti administrativ fillimisht ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 21.04.2020, ndërsa ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e ka parashtruar më datë 28.04.2020, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 14.05.2022 ka nxjerr Vendim me numër Reference 37/2020 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.*

Bazuar në këtë, ankuesi fillimisht është dashur të parashtroj ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit”* dhe nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse edhe pse Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 14.05.2020 ka nxjerr Vendim me numër Reference 37/2020, ankuesi kundër këtij vendimi nuk ka parashtruar ankesë apo nuk ka bërë plotësimin e ankesës së datës 21.04.2020, kështu që ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e para afatshme.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.129/2020

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



*Vendimi i dërgohet:*

- *Përfaqësuesit të ankuesit*
- *Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

